



PROMOVIMI I „DIALOGUT NDËRETNIK NË PUSHTETIN LOKAL

Për ne

Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike, është një organizatë joqeveritare, e themeluar dhe e regjistruar në vitin 2011, me seli në Mitrovicën e Veriut.

Organizata ka për synim të luftojë për të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit, demokracinë dhe një shoqëri të hapur, tolerante dhe paqësore në Kosovë si dhe rajon.


Rreth projektit

Projekti "Promovimi i Dialogut Ndëretnik në Pushtetin Lokal" është financuar nga National Endowment for Democracy (NED).

Projekti ishte krijuar për të fuqizuar Komitetet e Komuniteteve, për të promovuar marrëdhënie të mira ndëretnike në qeverisjen lokale në veri të Kosovës dhe për të mbështetur iniciativat e projekteve në shkallë të vogël në Mitrovicën e Veriut.




Objektivi i përgjithshëm i projektit është të lehtësojë bashkëpunimin ndëretnik ndërmjet komuniteteve në komunën e Mitrovicës Veriore.

Projekti është realizuar në periudhën nga 01 shkurt 2022 deri më 31 janar 2023



Duke punuar së bashku mund të ecim përpara!

Në kuadër të projektit janë mbështetur tre projekte të vogla në lagjet multietnike të Mitrovicës.

-  Hapësirat e lojërave sportive të përdorura nga të rinjtë dhe të rejat nga të gjitha komunitetet janë rinovuar në lagjen e Boshnjakëve.
-  Puna në Qendrën Kulturore në Kroin e Vitakut, u mbështet me blerjen e pajisjeve të nevojshme.
-  Një kënd lojërash për fëmijë u ndërtua në një ndërtesë të shfrytëzuar nga familje të pafavorizuara sociale në Kodër të Minatorëve.

OJQ ACDC mbështeti iniciativat në të tri vendbanimet multietnike në Mitrovicën e Veriut me qëllim të krijimit të një mjedisi miqësor dhe të qëndrueshëm për komunitete të ndryshme. Këto iniciativa të vogla u tregojnë komuniteteve lokale se me pjesëmarrjen e tyre mund të përmirësojmë kushtet e jetesës së të gjitha komuniteteve.



Trajnime për anëtarët e Komitetit për Komunitete

**Në kuadër të
projektit janë
mbajtur trajnime me
përfaqësues të komiteteve për
komuniteteve. Trajnimi synoi
të fuqizojë kokitetin për të
punuar në mënyrë efektive me
komunitetet në Mitrovicën e
Veriut për të vlerësuar nevojat
e tyre dhe për të formuluar
projekte.**



Për më tepër, OJQ ACDC organizoi dy konferenca publike, me qëllim të krijimit të sinergjisë ndërmjet përfaqësuesve komunal, liderëve të komuniteteve, shoqërisë civile dhe mediave për të mbështetur dialogun dhe bashkëpunimin ndëretnik në Mitrovicën e Veriut. Qëllimi i konferencave ishte prezantimi i rezultateve të projektit dhe projektit në përgjithësi për sa më shumë njerëz.

Hulumtimi mbi perceptimin e bashkëpunimit ndëretnik



Në kuadër të projektit, OJQ ACDC realizoi hulumtimin për të matur perceptimin e komuniteteve në Mitrovicën e Veriut për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik. Hulumtimi kishte për qëllim të kontribuojë në ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndëretnik dhe të mbështetë bashkëpunimin dhe iniciativat ndëretnike të cilat do të bashkojnë komunitetet në zonat multietnike në Mitrovicën e Veriut.



Advocacy Center
for Democratic Culture



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD